

Etika për fëmijë

Dhuratë e përmuajshme, nga revista "Etika"

Viti I Numri 4 - Prill 2011

Sa shumë të duam,
o Profeti ynë i dashur!



Burimi ynë ndriçues

I dashur fëmijë,
Selamun alejkum!

Allahu i Lartmadhëruar, i cili na njeh më mirë se ç'e njohim veten, dëshiron që të kesh shëndet, të jesh i lumtur dhe i gëzuar. Ai të tregon rrugët se si duhet të fitosh lumturinë e dy botëve dhe se si duhet të mbrohesh nga dënimet e dy botëve.

Burimi ynë i parë ndriçues është Kurani.

Burimi i dytë ndriçues është Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.).

Krijuesi i Lartë, gjithmonë, dëshiron që njeriu të vrapojë drejt përsosmërisë dhe model për këtë caktoi Hazreti Muhamedin, alejhis-selam, të cilit i shpalli Kuranin Famëlartë.

Mendoni për një çast një labirint. Hyni te një derë nga ku përballeni me 3-5 dyer të tjera. Dyert janë shumëngjyrëshe, të zbukuruara me lule e me plot e plot stoli të ndryshme. Por vetëm tek njëra prej tyre do keni mundësinë të ecni të sigurt. Cila prej tyre vallë do jetë dera, nga ku nuk do t'u vijë ndonjë rrezik dhe nëpërmjet së cilës do arrini edhe qëllimin që i kini vënë vetes? Patjetër që jeni në mëdyshje dhe jeni duke menduar... Nododheni, vërtet, në një moment shumë të vështirë...

Në çast vjen një zë e të udhëzon. Ai zë vjen nga lart. Ai zë di dhe njeh atë çfarë ka brenda labirintit... Kështu që, zëri të thotë se, kjo derë është e mbyllur, po të hysh te ajo derë do të kesh rrezik, sepse ajo derë është e zjarrit dhe përfundon në humnerë, ndaj, mos shko andej...

I udhëzuar nga një zë i tillë, ti me një

gëzim të madh i drejtohesh derës që të shpie aty ku dëshiron të shkosh. Ec më tutje... Përballesh sërish me dyer të tjera... Cila të jetë vallë dera e vërtetë? Sikur ta provosh këtë...? Si thoni, a do ta gjesh vallë, nëse e mendon edhe një çikë?.. Por, mos harro, zëri i lartë udhëzues është me ty, është brenda shpirtit tënd... Është zëri udhëzues jo vetëm për ty, por për tërë njerëzimin, është zëri i një burimi rrezatues. Këto fjalë të ëmbla quhen "Hadithe". Janë shpëtimi ynë nga rreziqet, vuajtjet dhe mundimet. Janë gjetja e lumturisë, i të jetuarit të lumturisë.

Një Hadith thotë "Buzëqeshja është një sadaka". Është bukur: si ai që fal buzëqeshje, si ai që merr buzëqeshje...

Një Hadith tjetër thotë: "Bëni më të mirën e punës që keni në dorë". Është bukur: Të bësh më të mirën e punës që ke bërë, e cila të jep lumturi dhe gëzim të pakufishëm. E kjo ndodh, si për ata që e kryejnë punën, ashtu edhe për ata që marrin frytet prej saj...

Një Hadith thotë: "Mos gënjeni", "Mos çënoni të drejtën e jetimit", etj. etj.

E shikoni, se sa mesazhe të rëndësishme na kanë mbërritur nga Pejgamberi ynë! Prandaj t'i mësoni me dashuri dhe t'i vini në jetë! Kështu do të bëheni njerëz të vlefshëm, njerëz të virtytshëm, njerëz që do t'u nderojnë përherë në jetë!

Uroj që në çdo vend të jemi me Pejgamberin!..

Ju lë amanet Zotit, miqtë e mi të ngushtë!



Përmbajtja

Kënga e folezës

4

Lepurushi humbi garën...

5

Gaffari, Aliu dhe Ismaili

6

“Fantazma”

7

Kush bën një të mirë,
e gjen atë...

8

Fuqia e dashurisë vëllazërore

9

Jeta e Omerit

12

Të njohim miqtë tanë, kafshët

16

Parafjala

Më një pëllumb krahëlëhtë,
shëtita tërë kontinentet.

Më një raketë të shpejtë,
zbrita në të gjitha planetet.

Më një delfin të murrmë,
përshkova dete e oqeanë.

Më një erë pa zhurmë,
globit i rashë anë e mbanë.

Më një rreze nga drita,
takova gjithë lulët e dhëut.

Askund s'ë gjeta atë ndjenjën
që të fal vetëm ATDHEU.

Hamdi Meça

Etika për fëmijë

Viti I Numri: 4 - Prill 2011

Administrator
i Progresi botime:
Shujip Bashan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor
& Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23 989

Redaktor:
Xhahid Bushati
xhahidbushati@yahoo.com
+355 69 28 20 975
Redaktore gjuhësore:
Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com

Adresa: L: Vasil Shanto - Rr: Çajupi - Shkodër - Albania / Tel: +355 22 254 634 / Fax: +355 22 254 633
Zyra e përfaqësimit Maqedoni: Rr: Stiv Naumov - Nr. 9 - lokal 25 - Shkup - Maqedoni / Tel: +389 71 956 271
Zyra e përfaqësimit Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu - pn. Ralin - Prizren - Kosovë / Tel: +381 29 222 795

Kënga e folëzës

Mos era e manushaqes,
mos era e lule kaçës,
mos ngjyrat e ylberit,
mos kaltërsi e qjellit,
mos vala e një lumi,
që doçkën lehtë tundi,
gërsheti i një shelgu,
fanari buzë një bregu,
lodrimet e një ylli,
gjeth-gjethet e një pylli,
mos dritëza e hënës,
shtatë notat e këngës,
mos era e një ftoi,
ngjyrat e një palloi,
fol, o zog, kush të zgjoi?
-Ci, as agu i mëngjesit,
ci, as kënga e këndesit,
as drita e bukurezës,
vetëm Kënga e Folezës.
-Ci-ci-ci, e para këngë,
ci-ci-ci, ka emrin Nënë!
Lëshon rreze, lëshon dritë,
fluturoj, e kam në shpirt!..

Lepurushi humbi garën...

- Sipas motivit të një përralle popullore -

Diku, jo larg një gëmushe, një breshkë takoi një lepurush, i cili sa herë fliste, veshët i mbante ngritur.

-Për ku vrapon kështu, moj breshkë?! - e ngacmoi lepurushi.

-Unë vërtet eci ngadalë, por, ama ty, ta kaloj, - u përgjigj breshka.

-Ashtu,ë! Që kur ke nisur të bëhesh mendjemadhe! Harrove, që unë jam më i shpejtë se era!

-E provojmë, o lepurush këmbëshpejti...

-Vërtet, do të matesh me mua?! - pyeti lepurushi.

-Po, - u përgjigj breshka. - Ç'më shikon i habitur?!

-Je e vendosur?! - pyeti përsëri lepurushi.

-Po. - Ke frikë nga gara?! - ia ktheu breshka.

-Unë?! Ha-ha-ha! - qeshi lepurushi. Meqë ngul këmbë, e provojmë... - Ja, kush do të arrijë më parë te Lëndina me Luleshqerra: Unë apo ti..?

U nisën të dy njëherësh: Breshka si breshkë, lepurushi si lepurush.

Vrapoi e vrapoi lepurushi. Kur arriti te një kodër e vogël, mendoi të kthente njëherë kokën pas se, mos shihte gjëkund breshkën. Nuk e pa dhe u gëzua.

"Deri kur të vijë breshka gjer këtu ku jam unë, duhet shumë kohë! Ndoshta gjysmë dite...".

Kështu tha lepurushi. Zuri vend pranë një kaçubeje dhe vendosi të bënte një sy gjumë. Pa një ëndërr të bukur, sikur kishte arritur i pari në Lëndinën me Luleshqerra.

Breshka, e pafjalë, eci e eci e nuk pushoi gjëkund. Udhës e thirri një dardhë që lulëzonte në një kopsht. Më larg, nga një kopsht tjetër, e thirri një mollë. Breshka nuk ndaloi përsëri.

Eci e eci... Për çudi, lepurush këmbëshpejtin nuk e pa gjatë gjithë udhës.

Eci e eci e nuk pushoi. Eci e eci e nuk pushoi... derisa mbërriti e para te Lëndina me Luleshqerra. U gëzua breshka. Teksa jetonte me gëzimin e saj, dëgjoi zërin e bletës Zhu Zhu që ishte mike në shtëpizën e luleshqerrave.

-Udhë të gjatë paske bërë, moj breshkë!

-Po. Jam në garë me lepurushin...

-Si... si?! - pyeti bleta dhe zhu zhu, u afrua.

-Jam në garë. Sikur... s'po e shoh...

-Ai ende s'ka ardhur..., - tha bleta dhe fluturoi, por u kthye shpejt dhe, i dhuroi një lule breshkës fitimtare. Breshka e falënderoi.

Po lepurushi çfarë bënte në këtë orë? Ai, pasi, u kënaq me gjumin dhe me ëndrën e bukur, u zgjua. Fërkoj sytë e pa përreth.

"Breshka nuk duket gjëkund! Eh, sa ngadalë, ecën e shkreta!", - tha me veten e tij lepurushi i sigurt për fitoren.

Për të zënë kohën e humbur vrapoi si era.

Lepurushi nuk kishte bërë shumë udhë, kur Lëndina me Luleshqerra u duk si në pëllëmbë të dorës. Teksa afrohej, arriti të dallojë një njollë të verdhë, e cila shpejt u shndërrua në... në... Sikur s'po u besonte syve. Nuk ishte ëndërr, por ishte e vërtetë. Ajo ishte breshka, me të cilën po bënte garë.

"Paska ardhur e para breshka..! I lumtë! Nuk qenka gjithçka shpejtësia. Por qenkan edhe vullneti, këmbëngulja, durimi, ato, që të bëjnë fitues", - foli me zë të lartë lepurushi.

Veshgjatit i erdhi turp ta takonte breshkën. Iku pa u ndjerë e fshehurazi, andej nga kishte ardhur.

Veshët e mëdhenj i mbante ulur...



Gaffari, Aliu dhe Ismaili

Një ditë vere disa fëmijë po lodronin pranë një përroi. Njërin prej tyre e quanin Gaffar. Ai i mërzhiste, i ngacmonte dhe i zemëronte kafshët sa më s'ka. Kafshët, sa e shikonin Gaffarin, iknin dhe fshiheshin menjëherë. Ishte bërë tmerri i tyre.

Gaffarit nuk i pëlqente asgjë, madje as lojërat që i propozonin shokët. Ai dëshironte të loznin një lojë që të bënte bujë.

Tërhoqi në një qoshe tre shokë, të cilët mendonin si ai. Pasi folën kokë më kokë, më në fund e gjetën lojën e shumëëndërruar. Të tjerët, kureshtarë, ishin në pritje për të parë se cila ishte loja e re me të papriturat e saj, të cilën e kishin menduar Gaffari dhe tre shokët e tij.

Gaffari dhe shokët e tij iu afruan vjedhurazi Aliut. E kapën për krahësh dhe prej këmbësh dhe e hodhën në përrua. Aliu nuk dinte not. Ai s'kishte shumë kohë që kishte ardhur në qytet.

Aliu u tremb shumë. U përpëliti disa herë duke lëvizur këmbë e duar, por pa dobi, sepse nuk dinte not. Bërtiste me të madhe e kërkonte ndihmë.

Gaffari dhe shokët e tij bënë sehirë e qeshnin me të madhe.

Njëri prej fëmijëve, të cilin e quanin Ismail, duke e parë shokun e tij në rrezik, u zhvesh menjëherë. Ismaili ishte i fortë dhe trim. Gaffari nuk mund të kapej dot me të.

Ismaili u hodh në përrua, notoi si notar i vërtetë dhe e nxori Aliun shëndosh në breg.


Ismaili i hodhi një vështrim plot zemërim Gaffarit. Donte që ai të kuptonte veprimin e gabuar që kishte bërë ndaj shokut.

Fëmijët e tjerë e rrethuan Ismailin dhe e përshëndetën. Guximi dhe veprimi i tij shpëtoi Aliun, që përpak desh u mbyti nga loja e pamenduar, e pakëndshme dhe e rrezikshme e Gaffarit dhe e shokëve të tij.

Një burrë, që ishte dëshmitar i gjithë ngjarjes, iu afrua Ismailit, i ledhatoi kokën dhe i tha: "Bir, ti bërë atë që ka thënë Pejgamberi ynë i Nderuar. Allahu qoftë i kënaqur prej teje!"

Pejgamberi ynë (a.s.) thotë:

"Besimtari është vëllai i besimitarit. Nuk i bën keq atij dhe nuk e lë në dorën e së keqes." (Ebu Davud, Edeb, 57)



“Fantazma”

Një natë, një tregtar po kthehej në shtëpi më vonë se zakonisht.

Rrugës pa një zezak të moshuar, i cili po përpiquej të kalonte natën pranë një muri. Tregtarit iu dhimbs dhe e mori në shtëpinë e tij. I dha supë të ngrohtë dhe e veshi me rroba të pastra. Më pas zezaku i moshuar fjeti në një dhomë të veçantë dhe bëri një gjumë të ëmbël.

Aty nga mesi i natës, zezaku dëgjoji ca zhurma. U zgjua, e me hap të ngadaltë iu afrua dritares. Nën dritën e zbehtë të hënës pa dy hajdutë që po përpiqeshin të hynin nga dritarja.

Zezaku bërtiti me të madhe: “Hej, ju! Çfarë po bëni, atje?”

Hajdutët, kur panë një këmishë të bardhë si bora, u tmerruan. U hodhën njëri mbi tjetrin, vrapuan duke thënë: “Të ikim sa më parë, se në këtë shtëpi paska fantazma.”

Gjatë rrugës, nga që nuk dinin se ku shkelnin, njërit iu thye këmba, ndërsa tjetri u plagos në kokë.

Njerëzit e shtëpisë u zgjuan nga zëri i zezakut të moshuar dhe zhurma e hajdutëve. I ndoqën keqëbërësit dhe i zunë jo larg shtëpisë.

Dhe Pejgamberi (a.s.) ynë e thotë bukur:

“Allahu do ta ndihmojë njeriun për sa kohë që ai e ndihmon vëllain e tij.”

(Muslim, Birr, 15)



Kush bën një të mirë, e gjen atë...

- Përrallë -

Na ishte një herë një princ dhe na kishte tre djem. Më të mëdhenjtë ishin shumë zevzekë (të prapë). Ata nuk e dëgjuan këshillën e babait dhe u larguan nga shtëpia. U sollën anekënd... Kur vunë re se qenë vonuar, nuk patën kurajë të ktheheshin.

Më i vogli priti. U mërzit vetëm dhe doli t'i kërkonte vëllezërit. I kërkoi, i kërkoi dhe më në fund i gjeti. Kur ai u tha dy më të mëdhenjve të ktheheshin në shtëpi se bota është mbushur me rreziqe, ata qeshën dhe u tallën me vëllain e tyre të vogël.

Vëllai i vogël nuk u tërhoq, prapë këmbënguli. Ata nuk pranuan. Atëherë edhe ai u nis për rrugë me ta.

Ecën e ecën... Në një anë të një rruge vunë re një fole milingonash. Vëllai i madh dhe i mesmi deshën ta prishnin folezën e milingonave dhe të argëtoheshin me ta.

-Lërin të qeta milingonat! Nuk ju lejoj t'ua prishni folezën e tyre! - u tha i vogli.

Dy të mëdhenjtë s'e zgjatën, por vazhduan rrugën.

Më tutje panë një liqen sykaltër, ku po laheshin ca pata.

-Le të kapim dy prej tyre, - tha i madhi. Janë shumë të shijshme, kur piqen mirë.

-Mos ua prishni gëzimin, - ndërhyri përsëri i vogli. As që do t'i prekni me dorë!

I madhi përsëri s'e zgjati dhe tre vëllezërit vazhduan rrugën.

Pak më tutje panë një koshere me bletë.

-Mjalti është i mirë, - tha i dyti. -Po mbledh ca gjethe të thara dhe po ndez një zjarr që t'i heq qafe këto bletë...

-Mjalti është ilaç që të shëron, - ndërhyri për të tretën herë i vogli. Edhe bletën duhet ta respektosh.

I dyti u bë gati të fliste, por pa se kishin mbërritur në fund të rrugës, nga ku dukej një pallat mbretëror.

U afruan te një derë. Trokitën dhe derën ua hapi një burrë flokëbardhë. Ata panë një tryezë prej guri. U afruan. Menjëherë kuptuan se pallati mbretëror fshihte magji dhe për ta shpëtuar nga kjo magji, ata duhej të kalonin me sukses tri prova.

Prova e parë ishte: Të gjenin një mijë margaritarë, të cilët fshiheshin mes algave dhe barishteve. Po të mos i gjenin deri në perëndim të diellit, tre vëllezërit ktheheshin në tri statuja.

I madhi gjeti vetëm 700 margaritarë. Me të perënduar dielli u kthye në statujë.

I mesmi gjeti vetëm 200 margaritarë. Me të perënduar dielli, edhe ai u kthye në statujë.

Tani i kishte ardhur radha më të voglit. U përpoq të gjente margaritarët, por më kot. Filloi të qante me të madhe. Zërin e tij ia njohën që larg milingonat. Dolën nga foleja. Fshehtas tij mblodhën margaritarët dhe ia sollën, duke e shpëtuar kështu djalin. I vogli nuk harroi t'i falënderonte.

Prova e dytë ishte gjetja e një çelësi dhome, i cili fshihej në fundin e një liqeni të thellë. Djali i vogël notoi e notoi, por nuk e gjeti. U ul në breg dhe nisi përsëri të qajë me të madhe. Zërin e tij ia njohën patat pendëbardha. Dolën nga shtëpiza. Fshehtas tij gjetën çelësin ku ishte fshehur në fund të liqenit dhe ia sollën, duke e shpëtuar kështu djalin. I vogli nuk harroi përsëri t'i falënderonte.

Prova e tretë ishte të dallonte princeshën më të bukur, që ndodhej në dhomë. Djali, nga frika se mos gabonte, nuk zgjodhi asnjërën. Këtë dilemë të djalit e kuptoi menjëherë vetëm princesha-bletë që e kishte shpëtuar nga zjarri, dhe i tha:

-Djalë i mbarë, kjo është më e bukura e princeshave!..

Në këtë çast u dëgjua një brohoritje e madhe. Pallati mbretëror kishte shpëtuar nga magjia. Të gjitha statujat u kthyen në njerëz. Edhe dy vëllezërit e tij. Të gjithë ishin të lumtur. Ata falënderonin djalin e vogël, kurse djali i vogël nuk harronte përsëri të falënderonte milingonat punëtore, patat pendëbardha dhe bletët krahëlehta.



Fugia e dashurisë vëllazërore

- Tregim -

Atë ditë Mehmeti qe kthyer mjaft i lodhur nga shkolli. Kishin fituar ndeshjen e futbollit me klasën tjetër, të zhvilluar në orën e fizkulturës. E ndiente veten si të kishte arritur një fitore të madhe. Kishte qenë kapiten i skuadrës, ndaj dhe krenohej.

I ra ziles. Priste të shihte të parën nënën, si gjithmonë me atë dashamirësinë e saj dhe zërin e saj prekës e melodioz. Por u habit, kur derën ia hapi një grua e panjohur.

-Aaaa! Mirë se erdhe, biri im! Ti me siguri, je vëllai i madh i Samiut të vogël.

Nuk i pëlqeu të quhej ashtu.

E vështroi gruan e panjohur dhe iu përgjigj:

-Unë quhem Mehmet. - dhe hyri brenda.

Në dhomë kishte aq shumë njerëz, sa me zor vuri re edhe nënën. E ëma po gostiste mysafirët. Të gjithë i ishin afruar Samiut dhe po e përkëdhelnin. E ëma i uroi mirëseardhjen Mehmetit dhe e uthi. Nuk i tha asgjë tjetër. Në fakt, çdo ditë bisedonin gjatë e gjatë... E ëma e pyeste se si i kishte kaluar dita. Ndërsa sot s'po e pyeste për asgjë. Mehmeti u mërzit dhe kaloi në dhomën e tij. U ndërrua, nxori nga çanta kompletin e tij sportiv dhe u shtri. Nga dhoma vinin të qeshurat e Samiut dhe zërat e mysafirëve. Mbylli sytë dhe nisi të mendonte... Kujtoi se një ditë më parë, vëllai i vogël i Selimit, njëri nga shokët e tij të klasës në shkollë, ish grabitur. Por shlyqyr Zotit që, policët kishin arritur ta kapnin grabitqarin, sapo ai kish tentuar të ikte dhe kështu e kishin shpëtuar atë.

Ishte lodhur shumë, kështu që, e zuri gjumi shpejt. Nisi të shihte një ëndërr. Shihte ca njerëz të këqij, që kishin grabitur Samiun.

"Tashmë mami dhe babi të kanë vetëm ty, nëse Samiu mungon... Tani, ty do të të duan më shumë", - thoshte njëri prej njerëzve të këqij.

"Po... po... është e drejtë!", - sikur i thoshte një zë nga brenda.

"Pa shiko, që kur erdhi në jetë ai, prindërit kujdesen më pak për ty. Po sot, a u mor mami me ty? As nuk të foli dhe as nuk të pyeti se si të kaloi dita. Ne do e marrim Samiun dhe do t'ua shesim një familjeje që s'kanë fëmijë. Kështu edhe ti do shpëtosh prej tij,

edhe ajo familje do bëhet e lumtur, pasi do ketë një fëmijë. Pra ti në fakt, do i bësh mirë asaj familjeje." - i folën ca zëra përmes natës.

Mehmetit iu bë sikur Samiu po qante. Ata donin ta merrnin. Samiu zgjaste duart drejt Mehmetit. Kërkonte ndihmën e tij.

Që kur kishte ardhur Samiu në jetë, ishte krijuar një marrëdhënie e mirë mes tyre. Samiu e donte shumë Mehmetin. Sapo e shihte, i buzëqeshte, i lëvizte duart, këmbët. Të gjitha këto iu kujtuan Mehmetit, teksa vazhdonte të shihte ëndrën. Në atë çast, kërkoi të ishte si Omeri, luftëtar i mirësisë. Dëshira, siç dukej po i realizohej. E pa veten të veshur me rrobta e luftëtarit të mirësisë dhe kështu e ndjeu veten më të fortë dhe më të sigurt. Vrapoi drejt grabitqarëve të Samiut. Iu drejtua njerëzve të këqij dhe me armën e tij i gjuajti ata... Njerëzit e këqij u bënë menjëherë të mirë. Ia dorëzuan Samiun, Mehmetit dhe i dhanë fjalën se nuk do bënin më gjëra të tilla të këqija.

Tani Samiu ishte në prehërin e Mehmetit, i buzëqeshte dhe ia shtrëngonte duart fort.

Më pas, seç dëgjoji një zë që nuk e kuptoi se nga i vinte, por ky ishte Pëtërxhëku, zogu i vogël. S'arrinte ta shihte. Pëtërxhëku cicëronte si zakonisht. Hapi sytë. Iu ul mbi sup dhe i cicëroi sikur të ishte një orë e kurdisur. Mehmeti u habit që pa veten në shtrat. E kuptoi menjëherë se kishte qenë në ëndërr.

U ngrit dhe doli nga dhoma. Mysafirët kishin ikur dhe në shtëpi kishte rënë qetësia. E ëma po lante enët në kuzhinë, kurse Samiu po flinte i qetë. Mehmeti shkoi pranë së ëmës, i tregoi ëndrën dhe të dy qeshën shumë.

- Pse vëllai yt erdhi në jetë, kjo nuk e ndryshon dashurinë që kemi për ty, - i tha nëna. Ne përsëri të duam shumë si më parë. Por... meqë ai është më i vogël, ka më shumë nevojë për përkujdesje dhe dashuri. Sot nuk munda të bisedoja me ty, ngaqë kishim mysafirë... Pa më thuaj biri im, si kaloi dita e sotme?

Mehmeti erdhi në vete. I gëzuar nisi t'i tregonte së ëmës për ditën që kishte kaluar. I tregonte dhe herë pas here e puthte në faqe dhe i përkëdhelte flokët.





BISEDA:

GJYSH, NIPËR E MBESA

Më i dashuri Profet
Ai jeton në zemrën tonë
Mësimet e tij vlejnë për jetë
E kujtojmë me mall gjithmonë.

Njërin emër e kishte Ahmed,
Ndërsa tjetrin Muhammed
Sal-lall-llahu ala Muham-med
Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem!

Gjysh Nuriu: Sa ilahi e bukur qenka, o fëmijë!
Ku e keni mësuar këtë?

Lavdërimi: Ma ka mësuar vëllai im, o gjysh.
Na pëlqeu shumë, prandaj e mësuam dhe po
e këndojmë me gjithë dëshirë.

Gjysh Nuriu: Po mirë, a e dini se çdo të
thotë Profet?

Ibrahimi: Ma ka mësuar njëherë motra, por
tani e kam harruar...

Gjysh Nuriu: Profet do të thotë, i dërguar
i Allahut. Pra, është njeriu që na ka sjellë
urdhrat dhe ndalesat e Allahut.

Hamzai: Edhe emri Ibrahim është emër
profeti apo jo?

Gjysh Nuriu: Po. Ibrahim, Ismail, Musa, Isa,
Adem, Jakup, Idriz dhe Jusuf janë të gjithë
emra të profetëve.

Merjemja: Ndërsa Profeti ynë është Muha-
medi (alejhis-salam).

Gjysh Nuriu: Po, Muhamedi (a.s.), është
Profeti i fundit i dërguar prej Allahut dhe është
Profeti ynë. Mirëpo, edhe profetët e tjerë janë
profetët tanë, sepse të gjithë janë të dërguar
prej Allahut dhe i kanë udhëzuar njerëzit në
rrugën e drejtë. Por sigurisht që urdhrat dhe
ndalesat e Islamit i mësojmë prej profetit tonë.
Çdo pjesë e jetës së tij është shumë e rëndë-
sishme për ne. Çdo vepër dhe çdo fjalë e tij
janë shembull për ne.

Aishja: Gjysh i dashur, si i merrnin profetët
urdhrat prej Allahut?

Gjysh Nuriu: Fëmijë të dashur, ka katër
melekë të mëdhenj. Njëri prej tyre, Xhebraili
(a.s.), është meleku që i sillte shpalljet profe-
tëve.

Hatixhja: Babai im më tha se, sapo e ka-
luam muajin në të cilin ka lindur Profeti ynë i
dashur.

Gjysh Nuriu: Po, bija ime! Profeti ynë i da-
shur ka lindur në ditën e 12 të muajit Rabiul-
euel, në vitin 571 me kalendarin e Hixhrit.
Ndërsa me kalendarin tonë për këtë vit ishte
në datën 14/15 Shkurt.

Hamzai: Unë kam dëgjuar për ditën e Mev-
ludit. Çfarë është Mevludi?

Gjysh Nuriu: Biri im! Mevludi është dita kur
ka lindur Profeti ynë. Në atë ditë kanë ndo-
dhur shumë gjëra të rëndësishme. Në palla-
tin mbretëror të Iranit u rrëzuan 14 shtylla, u
shua zjarri i shenjtë i adhuruesve të zjarrit që
qëndronte i ndezur që prej njëmijë vjetësh,
vërshoi uji i luginës Semave që përmyti çdo
gjë përreth dhe u tha liqeni Save. Të gjitha
këtu kanë ndodhur në momentin kur erdhi në
jetë Profeti ynë i dashur.

Jusufi: Sa ngjarje të çuditshme!..

Gjysh Nuriu: Po, biri im, ashtu është. Aaa...
ju sikur po këndonit një ilahi më parë. Si
vazhdonte ajo?

Fëmijët:

Ai vjen n'ëndrrat e f'mijve
Porsi dielli në mëngjes
Më i dashuri i njerëzimit
Zemrat na i mbush me shpresë.

Njërin emër e kishte Ahmed,
Ndërsa tjetrin Muhammed
Sal-lall-llahu ala Muham-med
Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem!

MINITEST



1. Kur ka lindur Profeti ynë (a.s.)?

- a) 510 b) 630
c) 571 ç) 671

2. Si quhej nëna e qumështit të Profetit (a.s.)?

- a) Amine b) Aishe
c) Zejnep ç) Halime

3. Cili është gjyshi i Profetit (a.s.)?

- a) Abdullah b) Abdulmutalib
c) Jusuf ç) Ali

4. Si quhet xhaxhai i Profetit (a.s.), i cili e rriti dhe u kujdes për të?

- a) Ebu Talib b) Ebu Leheb
c) Ebu Sufjan ç) Ebu Xhehl

5. Sa vjeç ishte Profeti (a.s.), kur i erdhi shpallja?

- a) 25 b) 40
c) 63 ç) 33

6. Ku emigroi Profeti (a.s.), pasi iku nga Mekka?

- a) Medine b) Sham
c) Hixhaz ç) Riad

7. Cili nga sahabët e shoqëronte Profetin (a.s.), gjatë emigrimit?

- a) Ebu Bekri (r.a.) b) Aliu (r.a.)
c) Omeri (r.a.) ç) Osmani (r.a.)

8. Sa fëmijë kishte Profeti (a.s.)?

- a) 7 b) 10
c) 3 ç) 5



(Përgjigjet do t'i gjeni në numrin e ardhshëm të revistës...)



Jeta e Omerit

NË NUMRIN E KALUAR
MËSUAT SE ANIJA
KOZMIKE E TË KËQIJE
ZBRITI NË TOKË.
TREGIMIN TONË DO
TA VAZHDOJMË PREJ
MOMENTIT KUR U
NJOHËM ME SHOKUN E
OMERIT, HASANIN DHE
VËLLAIN E TIJ MURATIN.





Adelina Mamaqi



PËRRALLËZA E SHKRONJËS



Unë jam shkronja e tretë, e alfabetit.
Përralla ime do t'ju tregojë çfarë tha njëherë...

CIRONKA

Në liqenin e madh sa deti, jetonte një cironkë e vogël sa gishti. Por kjo Cironka ishte shumë e mençur dhe e shkathët.

Njëherë, ndonëse peshqit flenë me sy hapur, atë e kishte zënë një gjumë i thellë. Befas ndjeu zhurmë. U zgjua dhe e tmerruar pa, se ndodhej në gojën e një krapi të madh.

- O krap, o krap, - mezi bëlbëzoi Cironka, që po i zihej fryma - të lutem, prit të të them një fjalë! E kam për të mirën tënde.

- Pa ta dëgjojmë! - foli krapi dhe hapi gojën.

Kaq deshi Cironka. U hodh "Ilum!" në ujë dhe i tha:

- O krap, ti je aq i madh, unë jam kaq e vogël. S'jam as sa një kafshatë për ty. Prit të rritem e të bëhem e madhe, pastaj vij e të futem vetë në gojë.

- Mirë e ke! - ia ktheu krapi. - Rritu sa më shpejt!

- Patjetër, - iu përgjigj Cironka, që e dinte se nuk do të rritej kurrë... Dhe, e lumtur, u zhyt mes valëve të kaltra...

PËRRALLËZA E SHKRONJËS



Unë jam shkronja e katërt, e alfabetit.
Ju e dini se zogjtë jetojnë te...

ÇERDHJA

Harabeli e kishte çerdhen te një bli i lashtë. Në pranverë shumë zogj shtegtarë erdhën e thurën çerdhet aty. Blii, nga gëzimi, çeli edhe më shumë lule plot aromë. Banorët e rinj jetonin në paqe me njëri - tjetrin. Edhe harabeli ishte i lumtur.

Iku vera. Erdhi vjeshta. Zogjtë shtegtarë nisën të largoheshin për në vendet e nxehta. Një mëngjes u bë gati për udhë tufa e fundit e zogjve, që kishte mbetur.

- Harabel! - i tha njëri prej tyre. - Përgatitu shpejt! Sot do të shtegtojmë të gjithë.

- Ju qoftë udha e mbarë, o mik! - ia ktheu harabeli. - Unë nuk shtegtoj.

- Ç'thua?! - u tmerrua zogu. - Po afrohet dimri. Ne zogjtë nga të ftohtit...

Po harabeli nuk e la të mbaronte fjalën:

- Edhe sikur te vdes, dua të vdes në çerdhen time! - i tha.

I përshëndeti miqtë e tij shtegtarë me këngën më të bukur që dinte.

Fjalëurtat... për maturinë, kujdesin dhe thjeshtësinë

- ◇ As mos u ngut, as mos u tut.
- ◇ Kush flet shumë dhe do gënjejë.
- ◇ Goja ta qet zërin, goja ta tret zërin.
- ◇ Gjuha flet e fshihet, shpina pret e rrihet.
- ◇ I marri kur hesht, s'është i marrë.

Mblodhi: Kastriot Mahilaj



Një fëmijë kureshtar pyet të atin:

-Babi, ca njerëz lindin të zinj. Pse?!..

-Sepse lindin natën..., - u përgjigj i ati.



-Çfarë i bëre lekët që t'i fala sot në mëngjes?! - pyeti e ëma Gentin.

-Ia kam dhënë atij plaku... të shkretë...

-Të lumtë! - Po më trego cilit plak?

-Ja, nënë, atij që shet me tavolinë: biskota, patatina, coca cola, ivi, byrekë, orbitë ..., te dera e shkollës.



G a z m o r e

-Gjysh, pse nuk lexon gazetat? - e pyeti nipi.

-Dua të ruaj gjyzlykët,-u përgjigj gjyshi.



Genci dhe Adi janë shokë të një klase.

Genci - Çfarë bën ti, Adi, kur ftohesh?

Adi - Unë... teshtij.



I ati - Mirë se prej ujit të njelmët nxirret kripa, po sheqeri nga nxirret, o bir?!

Djali - Prej ujit të ëmbëll..



-Babi, më blej një bori-lodër, - iu lut disa herë Bledi.

-Jo, se do t'i biesh gjithë ditën e nuk do të pushosh...

-Jo, o babi, do të jem i kujdesshëm. Do t'i bie borisë, vetëm kur të jesh duke fjetur...

Të njohim miqtë tanë, kafshët



Ada Mara

NUSEBUKURA

Nusebukura,
Buku - bukureza,
Mbi fustan të kuq
Plot pika të zeza!

Mos je parashutë
E vockël, thua,
Dhe endesh gjithkund
Me krahëzat e tua?

-Jo, jo, jam insekt.
Kur ti dorën hap,
Unë zbres me të shpejtë,
Edhe iki prapë!

-Ngjyrat kuq e zi,
Vallë, kush t'i vuri?
Apo, kushedi,
T'i dhuroi flamuri?





DALLËNDYSHJA

Në vjeshtë, larg niset e shkon,
Se të ftohtët s'e duron.

Në pranverë, kthehet më parë,
Nga të gjithë zogjtë shtegtarë.

Dielli rrugën ia rrëfen,
Që ta gjejë ku ka folenë.

Dhe folezën, në ballkon,
Siç e lë, e gjen gjithmonë.

Sapo vjen, urojmë të tërë:
"Mirë se erdhe, bishtgërshërë!"

Porse emrin e ka ndryshe:
Dallë-dallë-dallëndyshe!





MENDO PAK... E BUZËQESH

Këtu hyn, e aty del,
nëpër kopshte natën bredh...,
Veshgjati me dy dhëmbë,
a e dini sa ka këmbë?

katër

Orë s'ka e orë tregon,
që menatë nis e këndon...

këndesi

Nëpër ara rritem,
prashitem, ujitem,
dhe mustaqe kam,
e dini, kush jam?

mish

Me një këmbë qëndroj,
nga dielli vështroj,
bimë vajore jam,
emrin si e kam?

lule dielli


Pranë gjyshes rri,
pranë gjyshes fle,
por kur shfaqet miu,
zgjohet, tak! - e zë!

macja

....., natën del...,
ec e ec, shëtiti e ndrit,
po kur befas e takoj,
"flet" me mua, nuk ka frikë.

xikëllonja

VIZATO - NGJYROS



Fjalët e mëposhtme gjejini në tabelë në mënyrë horizontale, vertikale dhe diagonale.

T	A	I	S	U	Z	V	I	C	E	R	I
S	H	Q	I	P	E	R	I	C	I	D	B
E	G	E	R	F	C	I	N	T	E	K	R
Q	Z	R	I	S	B	A	N	U	A	L	U
I	L	G	N	A	R	E	S	R	M	L	S
B	L	V	R	F	U	P	T	Q	Y	J	I
I	N	A	M	R	E	J	G	I	K	P	O


1. Shqipëri
2. Turqi
3. Arabi

4. Siri
5. Itali
6. Greqi

7. Angli
8. Rusi
9. Francë

10. Suedi
11. Zvicër

CILA NGA FOTOT MUND TË PLOTËSOJË FOTON E MADHE?




A



B



C




D




E

VENDOSINI ÇFARË DUHET TË JETË NË VEND TË PIKËPYETJEVE.



VENDOSINI NË VENDIN E DUHUR EMRAT E FËMIJËVE TË PEJGAMBERIT TONË (A.S.).



* Kasim * Ummugulsum * Abdullah * Fatime * Rukije * Zejnep * Ibrahim



GAZMORE



BABI PA SHIKOJE NJËHERË, KAM KALUAR APO KAM NGELUR?

DËFTESË



TË GJITHA VËSHIRËSITË VIJNË NGA MOS MJAFTUESHMËRIA: 'ME PAK'.

NUK BËN TË LLASTOSH DEMBELIN DHE T'I PREMTOSH DIÇKA ME KUSHT TË ZELLSHMIT...

MOS SHKRUANI GJË NË KËTË MUR!..



PO TI A MË THE, QË E KE KRYER SHKOLLËN ME TË GJITHA DHJETA, MORE DJALËP?

PO BABA, TË GJITHË NOTAT SË BASHKU BËJNË DHJETË.

NË JETË, NJERIU ËSHTË I LUMTUR PËR AQ SA KA BËRË MIRË!..



A KA NDONJË VEND QË NUK KA SHKOLLA? NËSE KA, SA ËSHTË BILETA E AUTOBUSIT PËR ATJEP?..

KUSH RRËZOHET, RRËZOHET NGA SHERRI I TIJ.



HËMM!



ÇFARË MUND TË BËHEM ME KËTO NOTA, KUR TË RRITEM BABI?

?!?

Məvludi

- fragment -

*Erđh në dymja n'atë kohë që u besue
Gjithçā ishte e krijueme u shendue.*

*Shpirt e pā shpirt gur e dru thirrën me za
Gjith i thojshin. Mirse erđhe, Mustafa!*

*Mirse erđhe xhenneti sot u stolis,
Mirse erđhe i dashtuni i Perëndis!*

*Mirse erđhe, shpresa e zemrave tonë
Mirse erđhe, ej ndriçimi i syve tonë!*

*Mirse erđhe, ej dielli gjith dymjasë
Mirse se erđhe, ilaçi i zemrës fukarasë!*

*Mirse erđhe, ummeti jot tue qā me lot,
Borsesh e kemi për me ramun salavat.*



së
shpejti

